

DEKLARATË PËR SHTYP

RAPORTI THEKSON DOBËSITË E SIGURISË PORTUALE NË BALLKAN

Portet e kontejnerëve në Evropën Juglindore janë gjithnjë e më të cenueshme ndaj trafikimit të mallrave të paligjshme, sipas një raporti të titulluar "Portholes: Exploring the maritime Balkan routes", të publikuar sot nga Iniciativa Globale kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar. Duke nënvizuar një sërë konfiskimesh të mëdha të kokainës, heroinës dhe cigareve që nga viti 2018, autorët sugjerojnë se 'rruga tradicionale ballkanike' për trafikimin nëpër tokë po plotësohet nga rrugët detare në portet në Adriatik, Egje dhe Detin e Zi.

"Duket se ka një ndryshim në mënyrat e trafikimit," tha bashkëautori Walter Kemp. "Për shkak të masave të krijuara për të kufizuar flukset e migracionit dhe KOVID-it; efektit të zhvendosjes së konfiskimeve të mëdha të kokainës në Belgjikë dhe Holandë; dhe ndërprerjes së shkakuar nga lufta në Ukrainë, trafikantët po kërkojnë rrugë alternative."

Sasi të mëdha kokaine – zakonisht të fshehura në kuti me banane – në porte si Durrësi (Shqipëri), Ploçe dhe Rijeka (Kroaci), dhe Selaniku (Greqi) kanë ngjallur dyshime se portet e Evropës Juglindore po bëhen më tërheqëse për trafikantët. Kjo është shtuar nga konfiskimet e mëdha të heroinës në portet e Konstancës (Rumani), Koperit (Slloveni) dhe Varnës (Bullgari), si dhe problemi i gjatë i kontrabandës së cigareve, veçanërisht përmes porteve të Tivarit (Mali i Zi) dhe Pireut (Greqi).

Bazuar në rastet e studimit të këtyre nëntë porteve tregtare në rajon, raporti gjurmon rrugët kryesore të trafikimit dhe shpjegon teknikat e përdorura të fshehjes. Ai gjithashtu paraqet ekosistemin e porteve dhe dobësitë e tyre, dhe përshkruan aktorët kriminalë që veprojnë brenda dhe përreth porteve. "Në disa porte, duket se ka qeliza të grupeve kriminale që veprojnë si pjesë e rrjeteve më të gjera ndërkombëtare," tha autori kryesor Ruggero Scaturro. "Disa porte janë magnetë krimi, jo vetëm që tërheqin grupet kriminale lokale, por edhe ato nga vendet e mbyllura në tokë që kanë nevojë për një dalje në det."

Rritja e investimeve në infrastrukturë do t'i bëjë portet e Ballkanit më tërheqës për biznesin – e ligjshëm dhe të paligjshëm. Prandaj është e rëndësishme të përmirësohet siguria e porteve rajonale si dhe të rritet bashkëpunimi midis organeve të zbatimit të ligjit përgjatë rrugëve detare të Ballkanit", shtoi ai.

Raporti thekson se siguria e porteve në Evropën Juglindore është përmirësuar në dekadën e fundit për shkak të investimeve më të mëdha në teknologji, harmonizimit me standardet ndërkombëtare të sigurisë, si dhe mbështetjes dhe trajnimit nga organizata si Zyra e OKB-së për Drogën dhe

Krimin dhe EUROPOL-i, dhe ndihma dypalëshe. Por, si në portet e tjera anembanë botës, përmirësimet teknike ndonjëherë zhbëhen nga korrupsioni.

Raporti thekson gjithashtu cenueshmërinë e lumit Danub ndaj trafikimit. “Danubi duket se është një pikë qorre dhe meriton vëmendje më të madhe, veçanërisht për shkak të potencialit për kontrabandë karburanti”, tha Kemp. "Kërcënimi i paraqitur nga tregjet e zeza rreth Detit të Zi duhet të rrisë bashkëpunimin rajonal të agjencive të zbatimit të ligjit" sugjeroi ai.

Autorët rekomandojnë gjithashtu një bashkëpunim më të madh midis menaxherëve të portit, oficerëve të policisë, kompanive të transportit detar dhe agjencive doganore përgjatë rrugëve të njohura të trafikut, për shembull midis Amerikës Latine, Evropës Perëndimore dhe Ballkanit Perëndimor.

“Ne duhet të kalojmë nga thjesht shikimi i sigurisë së porteve në ndjekjen dhe ndërprerjen e flukseve ndërkombëtare”, përfundoi Scaturro.

Për pyetje të mëtejshme apo për të intervistuar autorët e raportit, ju lutemi kontaktoni Claudio Landi (Claudio.landi@globalinitiative.net).

Rreth Iniciativës Globale

Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet profesionistësh, të cilët punojnë në frontin e luftës kundër ekonomisë së paligjshme dhe aktorëve kriminalë.

Përmes një rrjeti global vëzhguesish të shoqërisë civile të ekonomisë së paligjshme, ne monitorojmë trendet në zhvillim dhe punojmë për të ndërtuar bazën e provave për krijimin e politikave, shpërndarjen e ekspertizës së Rrjetit tonë dhe përsheptimit të ndërhyrjeve të plota në një gamë të gjerë llojesh kriminaliteti. Me Fondin e Rimëkëmbjes së Iniciativës Globale, ne mbështesim aktivistët e komuniteteve dhe Organizatat Jofitimprurëse që të punojnë në ato zona, ku qeverisja e krimin vë seriozisht në rrezik jetën dhe sigurinë e njerëzve.

